



Misioni ynë

Revistë informative, kulturore dhe shpirtërore, viti IV, nr. 14, prill-qershor 2024

Shtegtimi i ynë në Lourdes, një tregim ndryshe ...

Faqe 12–13



Misioni Katolik Shqiptar
Katholische Albanische Mission

LUZERN

REVISTË INFORMATIVE, KULTURORE
DHE SHPIRTËRORE E MISIONIT KATOLIK
SHQIPTAR NË LUZERN



SELIA E REVISTËS
Rodteggstrasse 6, CH-6005 Luzern
St. Michael



Tel: +41 41 250 52 60



anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch
albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch
ukas_cr@hotmail.com



<https://www.misioni-lu.ch/>



[https://www.facebook.com/ Misioni Katolik
Shqiptar - Luzern](https://www.facebook.com/Misioni%20Katolik%20Shqiptar-%20Luzern)



TË NDIHMOJMË REVISTËN

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3
Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 |
6005 Luzern

REDAKSIA

Dr. Don Anton Uka – kryeredaktor
Motër Vida Ademi – koordinuese
Veneranda Qerimi – redaktore e teksteve
Mirlinda Dushi Berisha – përgjegjëse për
intervista
Gjane Simoni – asistente
Motër Mrika Sabedini – asistente

faqe

5 **AKTIVITETET E MISIONIT**

Seminari shpirtëror në Mision

8 **AKTIVITETET E MISIONIT**

Shtegtimi në Itali

10 **AKTIVITETET E MISIONIT**

Festa e Zojës së Këshillit të Mirë

12-13 **AKTIVITETET E MISIONIT**

Shtegtimi i ynë në Lourdes, një tregim ndryshe ...

14-15 **AKTIVITETET E MISIONIT**

Dita e Nënave

18-19 **INTERVISTA**

Intervistë me motër Mrika Sabedini

20-21 **PËRSHPIRTËRI**

Pelegrinazh në Zemër të Besimit

28-29 **AKTUALITET**

Karlo Akutis i shenjtë

30-31 **KUKTURË**

Bildungsreise in den Kosovo

33 **PSIKOLOGJI**

Përzemërsia dhe humori

34-35 **AKTUALITET**

Ferienzeit im Kosovo:
Eine freudige Heimreise mit Würde und Respekt

Madhështia e njeriut qëndron në besimin e tij

Njeriu i ditëve tona, ashtu sikurse ai i kohërave të kaluara, për shumë arsye personale, familjare dhe shoqërore, është i mbuluar me petkun e trishtimit dhe të mjerimit. Andaj, në brendësinë e tij mendore dhe shpirtërore shumë herë vuan, qanë, rëndon, ankton dhe vajton për fatin dhe mjerimin e vet dhe të botës në të cilën jeton. Kjo gjendje pakënaqësie, përveçse trishton njeriun, në një farë mënyre e trishton edhe Hyjin, pasi që Ai ndjen dhembshuri për bijtë e vet, jo dhembshuri në distancë apo mos përfshirëse, por atë lloj dhembshurie që e ka vullnetin dhe guximin brenda vetës të ballafaqohet me situatat, vuajtjet, ankimet dhe rënkimet e atyre njerëzve që kanë nevojë për ndihmë dhe ngushëllim (krh. Lk 10, 25-37).

Fjala e Zotit, ashtu sikur edhe krejt jeta e Jezusit, është një ftesë e lirë që i drejtohet njeriut të të gjitha kohërave të dalë nga vetvetja dhe nga çdo gjë që e rëndon dhe e robëron, për të shkuar në takim drejt Atij që jep jetë dhe çliron. Fakti se Hyji e thërret njeriun në vlera dhe gjëra të larta nënkupton se Hyji beson në njeriun dhe në fuqitë e tija që realisht posedon, për të shndërruar dhe përmirësuar jetën brenda a dhe jashtë tij. Jo rastësisht krejt porosia biblike tregon se madhështia e njeriut qëndron në besimin e tij.

Shumë herë ndodh që mëkatet personale dhe ato kolektive, adhurimi i zotave të rrejshëm, dhënia pas qejfeve dhe veseve, harresa e premtimeve të dhëna, mungesa e jetës shpirtërore etj., në këndvështrimin biblik, konsiderohen largim dhe mërgim nga Zoti dhe nga e vërteta. Ndërsa pendimi, kthimi, adhurimi ndaj Hyjit të vërtetë, dhënia pas gjërave të Zotit, rikujtimi dhe mbajtja e besëlidhjes dhe mbështetja e në Autorin e jetës konsiderohen kthim në Tokën e premtuar, gjëra këto që shkaktojnë gëzim dhe falënderim në zemrën e njeriut dhe të popullit.

Ikja e njeriut nga e vërteta dhe Zoti, për çfarëdo arsye që mund të ndodhë, do të prodhon brenda tij vuajtje dhe pakënaqësi të vazhdueshme.

Në pyetjen Pse njeriu modern është cinik dhe larg Zotit? që gazetari hebre Alain Elkann e pyeti kardinalin Carlo Maria Martini, ky i fundit u përgjigj kështu: “Vërtet nuk e di a është njeriu modern më larg Zotit apo njeriu antik. Jam i sigurt që njeriu është i shikuar nga Zoti me butësi të pafund, me dashuri dhe mëshirë, për këtë arsye objektivisht është “afër” tij. Dhe është një moment i jashtëzakonshëm ai në të cilin njeriu vetëdijësohet për shikimin dhe afërsinë e dashurisë së Hyjit të vet.”

Të dashur lexues, sado të humbur apo të trishtuar që mund të ndihemi, për shkak të një jete ndoshta të jetuar keq dhe pa përgjegjësi, nuk është kurrë vonë të kthehemi dhe të ecim në fe dhe në dashuri. Feja për shumë njerëz është si një ecje e vështirë ose një ngjitje në majën e një mali të karakterizuar nga mjegull dhe stuhi, por nëse besojmë plotësisht në Zotin dhe premtimet e tij, në një moment të caktuar gjithçka mund të ndryshojë. E rëndësishme është të përshkojmë rrugën që të çon te qëllimi, duke qëndruar të palëkundur deri në fund, të bindur se Zoti do të na ndihmojë dhe do të na nxjerrë nga errësira në dritën e mëshirës dhe dashurisë së tij.



(Foto: Don Anton Uka)

TURNE HUMANITAR NË SHAH

Edhe këtë vit me 16-të mars u zhvillua me shumë sukses turneu i shahut në Misionin tonë të Luzernit.

Morën pjesë 46 shahistë të moshave dhe kombësive të ndryshme.

Organizimi, falë Gazmend Dedajt në bashkëpunim me Zef Ramaj, Albert Nikolla, Avgustin Ramaj, Driton Tomaj, Samuel Bekaj, Eduard De-

daj, Vilson Gjoni e të tjerë, ishte i një standarti të shkëlqyer dhe pjesëmarrësit ishin shumë të kënaqur. Para se të vendosej shorti, mbrëmjen e bëri edhe më të këndshme prezantimi i një grupi të rinjsh të Ansambllit tonë "Shqiponja", të cilët interpretuan në skenë vallet tona tradicionale shqiptare.

Pas 9 ndeshjesh për secilin u shpallën fituesit: vendi i parë Murtez Ondoshi; vendi i dytë Agim Agushi; vendi i tretë Gjon Gojani.

Konkurrenca ishte e madhe dhe shumë e respektueshme. Çmimet për tre vendet e para u sponsorizuan nga: Masar Bajraj, Ilir Fanaj dhe Kelemnd Shtufi; ndërsa çmimi për fituesin më të vjetër dhe më të ri të konkursit u sponsorizua nga Gegë Dedaj.

Falë njerëzve të gatshëm për organizim dhe shërbim, si dhe sponsorëve, në këtë turne u mblodhën 2027.chf- franga dhe 16 euro, të cilat do të dhurohen për bamirësi.



(Foto: Gaspër Merturi)

Shkruan: Redaksia



(Foto: Don Anton Ulka)

SEMINARI SHPIRTËROR NË MISION

Nga data 21-23 mars u mbajt Seminari Shpirtëror i Pashkëve në Misionin tonë. Seminari u drejtua nga z. Dedë Paloka nga Prishtina.

Gjatë këtyre ditëve, ai trajtoi temën e rëndësisë së lutjes dhe të bashkëpunimit të ndërsjellët me Zotin.

Zotëri Dedë Paloka foli qartë dhe mirë. U mundua që të pranishmëve t'ju japë mesazhin e krisherë dhe të informonte për temat e përgatitura.

Të pranishmit mbetën të kënaqur sepse përvoja të tilla ndihmojnë edhe më shumë për një bashkim me Zotin dhe ndihmojnë të jetojmë si vëllezër e motra mes njëri-tjetrit. Kjo vërehej edhe tek pjesëmarrësit sepse ata bënë shumë pyetje lidhur me sqarimin e shumë gjërave për të cilat ndjenin nevojën të dinin edhe më shumë.

Për gjithçka falënderojmë Zotin për mundësitë që na jep nëpërmjet Misionit tonë dhe nëpërmjet njerëzve që na ndihmojnë në jetën tonë shpirtërore.

Falënderojmë gjithashtu zotëri Dedë Palokën për dëshminë e mirë dhe fjalët e drejtuar të gjithëve gjatë ditëve të seminarit.



(Foto: Nue Tuqi)

Shkruan: m. Vida Ademi



PASHKËT NË LUZERN

(Foto: Nue Tuqaj)

Festa e Pashkëve, duke filluar nga e Diela e Larit, në Misionin tonë u kremtua me solemnitet të madh në praninë e një numri shumë

të madh besimtarësh, miqsh dhe dashamirësh, të cilët morën pjesë në të gjitha kishat ku u kremtua Mesha e shenjtë.

Të enjten e madhe përkujtuam Darkën e Fundit të Jezusit me Apostujt, në kishën pranë qendrës së Misionit tonë. Gjatë kremtimit të Meshës së shenjtë, Don Antoni, duke kujtuar veprën dhe shembullin e Jezusit, lau këmbët 12 apostujve, të cilët, këtë vit, ishin të rinjtë e Misionit tonë. Pas Meshës së shenjtë, besimtarët qëndruan në lutje personale në kishë, ndërsa apostujt dhe prindërit e tyre morën pjesë në darkën e përbashkët të ofruar nga Misioni.

Të Premten e Madhe – tri misionet katolike shqiptare në Zvicër, lutën Udhën e Kryqit në shenjtëroren e Zojës në Einsiedeln. Kurse në mbrëmje, në Luzern, u kremtuan Ritet e Mundimit të Jezusit, më pas deri në mesnatë besimtarët, në grupe të vogla dhe me familjet e tyre, u lutën duke adhuruar kryqin e Krishtit që i solli shpëtimin botës.



(Foto: Kastriot Frokaj)

Natën e Pashkëve në Mision u kremtuan tre meshë të shenjta: Gettnau, Emmenbrücke dhe Inwil - Zug, ndërsa ditën e Pashkëve Mesha shenjte u kremtua në Goldau dhe në Sursee.

Ditën e Pashkëve në Sursee, pas pagëzimit të disa të rriturve, emocionet e gëzimit dhe të falënderimit të asaj mase të madhe njerëzish ishin edhe më të dukshme.

Për gjithçka falënderojmë Zotin dhe të gjithë ata njerëz që na ndihmuan në organizimin dhe kremtimin e festës.

Shkruan: m. Vida Ademi



(Foto: Nue Tuqi)

At Luigj dhe dom Gjoni drejt Lumnimit

Nëpërmjet një komunikate, Selia e Shenjtë, më datën 20 qershor 2024, shpalli dekretin e Dikasterit për Çështjet e shenjtërve, përmes të cilit Ati i Shenjtë, Papa Françesku dekreton dhe autorizon Lumnimin e Atë Luigj Palajt dhe Dom Gjon Gazullit.

Atë Luigj Palaj është personifikimi më i mirë dhe më i qartë i vuajtjes nga persekutimi i katolikëve shqiptarë të Kosovës. Në vitin 1913, ndërsa në Kosovë dhe më konkretisht në Gjakovë, vazhdonte fushata e egër e persekutimit dhe asimilimit të katolikëve shqiptarë, Atë Palaj u gjend në krye të detyrës duke inkurajuar besimtarët e asaj treve që të mos e lëshonin besimin e të parëve dhe identitetin shqiptar. Për këtë arsye, për shkak të një urrejtjeje patologjike ndaj çdo gjëje katolike dhe shqiptare, pushtuesit malazezë e arrestuan dhe e torturuan në mënyrë çnjerëzore. Pas një periudhe të gjatë burgosjeje në burgun e Gjakovës, ku edhe pse nën tortura të tmerrshme nuk e pranoi ndërrimin dhe mohimin e fesë, ai u tërhoq zvarrë nëpër rrugë dhe u shporua me bajoneta në Pejë, duke gjetur vdekjen e menjëhershme.

Dom Gjon Gazulli u ekzekutua, nga Mbreti Zog, me varje, në Shkodër, më 5 mars të vitit 1927. Ai ishte një kundërshtar i mbretit Zog për shkak të politikave të tij shpeshherë diskriminuese ndaj zoneve katolike, kryesisht Dukagjinit. Gjithashtu ai kundërshtoi ashpër dhe hapur të ashtuquajturin “bashkim personal të Shqipërisë me Jugosllavinë”.

(Marrë nga R.V.)



(Foto: Don Anton Uka)



(Foto: Anonim)

Nga data 2 deri më 6 prill, një grup prej 52 personash nga Misioni ynë përjetuam një përvojë të veçantë shpirtërore në vende të shenjta dhe të bukura në Itali.

Pas një udhëtimi të gjatë me autobus, mbërritëm në qytetin e vogël San Giovanni Rotondo për të vizituar vendet ku jetonte dhe punonte Shën Padre Pio. Ne kremtuam meshën e shenjtë pikërisht në kishën ku Shën Padre Pio qëndroi për orë të tëra duke rrëfyer besimtarët e shumtë të ardhur nga të gjitha anët e botës.



(Foto: Kristi Uka)

Më pas u nisem për në shenjtëroren e Zojës së Këshillit të mirë në qytetin e bukur të Genazzanos. Një vend i rëndësishëm për ne shqiptarët, pasi këtu ruhet ikona origjinale e Zojës së Këshillit të Mirë.

Një moment i veçantë dhe shumë emocionues për të gjithë të pranishmit ishte vizita e bërë në qytetin e amshuar, të Romës dhe Vatikanit, si dhe mundësia për të kremtuar meshën e shenjtë pikërisht pranë varrit të Shën Pjetrit.

Dita e fundit e udhëtimit tonë ishte e rezervuar për qytetin e Shën Françeskut të Asizit. Ky qytet është i pasur me histori dhe bukuritë rralla artistike.

Gjatë qëndrimit tonë në Itali përjetuam momente të bukura dhe shumë të rëndësishme për kulturën dhe jetën tonë shpirtërore.



Shkruan: Redaksia (Foto: Gazmend Dedaj)



KREMTIMI I PËRVJETORËVE

(Foto: Valentina Prenrecaj)

Përveç aktiviteteve të shumta shpirtërore dhe kulturore, Misionit tonë nuk i mungojnë momentet e bukura miqësore dhe argëtuese, si festimi i ditëlindjeve apo ngjarje të tjera të bukura që lidhen me jetën e bashkëpunëtorëve tanë.

Në mbremjen e 13 prillit, në ambientet e Qendrës sonë në Luzern, kori i Misionit së bashku me Forumin e Grave kremtuan 60-të vjetorin lindjes së Marie Koshit, anëtare e korit dhe 50-të vjetorin e m. Mrika Sabedini, drejtuese e Korit. Ndërsa më 20 prill, në mbremje, u festua 40-të vjetori i lindjes së Kolë Milicit. Ishin festa vërtetë të bukura dhe vëllazërore me shumë të ftuar.

Kremtimi i jubileve është rast i mirë në radhë të parë për të falënderuar Zotin për jetën e dhuruar, për shëndetin, për familjen për punën e mundësuar dhe për gjithçka që kemi.

Ne si Mision falënderojmë dhe njëkohësisht urojmë ata që tashmë kanë festuar sepse me angazhimin dhe kontributin e tyre ndihmojnë punën dhe shërbimin tonë për të mirë e të gjithëve.



Shkruan: Redaksia

(Foto: Valentina Prenrecaj)



FESTA E ZOJËS SË KËSHILLIT TË MIRË

(Foto: Nue Tuqi)

Më 26 prill, në qendër të Misionit tonë në Luzern, u kremtua festa e Zojës së Këshillit të Mirë, pajtore e Misionit tonë. Meshën e shenjtë në orën 19.30 e mbajti misionari Don Anton Uka dhe para kremtimit të meshës u lut Rruzarja e Zojës. Në predikimin e tij Don Antoni shpjegoi kuptimin e të qenit pajtor ose pajtore e një kishë.

Misionarët dhe misionaret që shërbejnë në Misionet Shqiptare në Zvicër ishin të ftuar për të marrë pjesë në kremtimin e festës sonë, por vetëm Motrat e Bijave të Dashurisë Hyjnore që shërbejnë në Sirnach ju përgjigjën ftesës për të marrë pjesë.

Në këtë ditë të veçantë jemi të ftuar t'i besojmë dhe t'i lutemi Zojës për nevoja të ndryshme, si ato personale, familjare, por edhe për paqen në botë, aq të nevojshme sot ku shpërthimi i luftërave nuk ka kufi. Po ashtu jemi të ftuar të kërkojmë mbrojtje dhe këshilla prej saj në të gjitha situatat e jetës dhe në mënyrë të veçantë t'i kërkojmë të na drejtojnë gjithmonë tek Biri i saj që të jetojmë dhe të qëndrojmë në rrugën e tij, sepse Ai është Rruga dhe jeta e vërtetë dhe kjo është e rëndësishme për secilin njeri.

Shkruan: m. Vida Ademi



(Foto: Nue Tuqi)



(Foto: Nue Tuqi)



NË FESTË ME "SHQIPONJAT"

(Foto: Gaspër Merturi)

Më 8 qershor 2024, në ambientet e Misionit në Luzern, u mbajt festa vjetore e Ansamblit tonë Shqiponja. Ky eveniment i veçantë kishte për qëllim një falënderim për prindërit tanë, për Don Anton Ukën, për motrën Mrika dhe motrën Vida, si dhe për Ansamblin "Trojet" të drejtuar nga mësuesi ynë i vallëzimit z. Arsim Berisha.

Në të rinjtë fillimisht përshëndetem të pranishmit, më pas shpërndamë disa dhurata në shenjë falënderimi për ata që na mbështesin në rrugëtimin tonë dhe në fund prezantuar programin e pasur dhe të mirëorganizuar të mbrëmjes.

Më pas Don Antoni në emër të të gjithë të pranishmëve përshëndeti dhe përgëzoi të rinjtë për angazhimin, përkushtimin dhe dëshirën për të bërë diçka të bukur për veten dhe për bashkësinë tonë në përgjithësi.

Festa ishte një kënaqësi e veçantë për të gjithë të pranishmit. Kishim përgatitur një darkë tradicionale dhe një program të pasur kulturor e argëtues. Pati një kuiz njohurish, në të cilin morën pjesë të gjithë me entuziazëm, si dhe sofër tradicionale, e cila krijoi një atmosferë vërtet të këndshme. Për

të ruajtur momentet e bukura, kemi zbukuruar dy "Fotoecke". Sigurisht që edhe ne vallëzonim dhe të gjithë u argëtuan shumë.

Kënaqësia jonë si Ansambël u rrit kur vumë re një gëzim të papërshkrueshëm dhe një krenari të madhe në sytë e familjarëve tanë. Kjo na bëri shumë të lumtur!

Shkruan: Denisa Merturi, Sursee



(Foto: Anonim)



Mbresat dhe përjetimet në shtegtimin në Lourdes, do të mbeten të paharrueshme në jetën tonë ...

Natyrë e qetë e pranisë së shenjtëve dhe aroma e pazakontë e një qyteti të vogël si Lourdes e bënë shpirtin tonë të ndjehet në harmoni me Krijuesin. Udhëhequr nga një ndjenjë madhështore ndalova para shkallëve të Bazilikës së Shenjtë të Lourdes. Në këtë vend të cilin shumë e quajnë "Purgatorium në tokë", atmosfera e shenjtë dhe misterioze më bënë të ndihem si në një botë tjetër.

Hapi dyert e të menduarit të thellë, shtrëngohem në mes të turmës së njerëzve që vijnë për të përjetuar mrekullinë e këtij vendi, ku Bernadettes se re i lajmërohet Zoja e Bekuar (Bernadette Soubirous, emri i pagëzimit Marie Bernarde Soubirous, në lehtësi ndonjëherë edhe Maria Bernadette Soubirous (e lindur më 7 janar 1844 në Lourdes, vdekur më 16 prill 1879 në Nevers në Loire), ishte një motër nderi franceze, të cilës, në moshën 14-vjeçare, i është shfaqur gjithsej 18 here Shën Maria virgjër, mes 11 shkurtit dhe 16 korrikut 1858.) Ndjenjën e frymëzimit shpirtëror dhe qetësinë e brendshme e përjetoj në çdo hap. Në sytë e mi të hutuar, që lëvizin mbi rrugët harkore të Lourdes, pamjet e rrezeve të diellit duken sikur të jenë ngjyrat e një pikturë të lashtë.

Eksploroj rrugët e ngushta të qytetit duke u mahnitur nga ndërtimet historike që shoh. Muret e vjetra të gurit, banesa tradicionale dhe dyqanet e vogla që ofrojnë produkte të shenjta, përforcojnë ndjenjën e një vendi që ka dhe ka bartur në histori dhe emocione nëpër shekuj.

Pasi kalova ditën në një lëvizje të vazhdueshme mes besimtarëve dhe vizitorëve, shkëputem në një moment nga turma dhe u ktheva në oborrin e Bazilikës së Shenjtë. Në heshtje nën hijen e madhe të një



(Foto: Avgustin Ramaj)

peme shekullore, përjetoj një moment qetësie dhe përçafimi të thellë me të ekzistuarit. Në atë moment ndjeva se çdo pikë dhe detaj në jetën time ishte vendosur në vendin e duhur dhe secila përvojë e imja ishte një hap i udhëtimit tim shpirtëror. Shtegtimi im, ynë (imi dhe gruas sime Borës) për në Lourdes, dhe Lourdes më të gjitha mrekullitë dhe misteret e veta do të mbetet përgjithmonë në kujtesën time si një nga rrugëtimet me të mrekullueshme dhe frymëzuese që kam (kemi) bërë ndonjëherë.

Një tingëllim i butë zëri u dëgjua më fillimin e meshës në gjuhën shqipe. Ky zë i butë i Dr. Don Anton Ukës, misionari ynë, i Misionit Katolik Shqiptar në Luzern, që në fillim dukej sikur të ishte një eklips i thjeshtë zëri, shpejt u përhap si një zë i shenjtë që udhëhiqte procesionin dhe predikimin me një prezencë të shenjtë, madhështore, shumëdimensional dhe frymëzuese. Thirrjet e tij të buta dhe fjalët e urta rreth besimit dhe dashurisë së Zotit, tërhiqnin vëmendjen e të gjithëve. Ai nuk ishte vetëm një predikues, por një udhëheqës shpirtëror që përfaqësonte fjalën e Zotit dhe përçmonte një frymë të ngrohtë dhe të dashurisë ndaj të tjerëve.

Pas kryerjes së shërbimeve të detyrueshme, në kohën e lirë, humori kuptimplotë i dr. Don Anton Ukës e bënte atmosferën edhe një here më të mirë dhe më të këndshme për ne shtegtarët.

Kurse puna e palodhshme dhe përkushtimi i motrës Mrikë dhe i motrës Vidë ishte një gjë që rralë kund mund të shihet. Ato ishin të zellshme dhe të përkushtuara për të gjithë shtegtarët nga Luzerni por edhe më gjërë.

Rrugët e Lourdes u bënë një nga qendrat e shpirtit dhe ndjenjave të njerëzve, një vend ku besimi, përlësia dhe dashuria u bashkuan për të formuar një harmoni të pazakontë. Dhe nën hijen e qiellit tërësisht të hapur, besimtarët dhe vizitorët u përçafuan nga ndjenja e një bashkëlidhjeje të thellë, duke ndarë momente të shenjta në këtë qytet të shenjtë.

Tavolina jonë në restorantin e hotelit Paradise ishte shndërruar në një tavolinë gazmore, përveç ushqimit aty bënëim llafe, humor, çlodheshim dhe shijonim shtegtimin tonë. Unë dhe gruaja ime Borja u njoftuam me çiftet Gjon dhe Bete Margegaj, Frrok dhe Mana Lleshi. Kurse aty me ne ishin edhe Nikollë Bushaj, Manusha Bushaj, si dhe kushëriri im Pren Berisha më bashkëshorten Mrika, si dhe për herë të parë takova edhe kushërirën time Violeta Bushaj dhe bashkëshortin e saj Palin.

Ky përjetim shpirtëror dhe emocionues i ynë, formon kujtime të paharrueshme që ranë thellë në shpirtin tonë dhe që mbeten me ne përjetësisht. Këto momente të veçanta janë si një pllakë e vlefshme që mbart historinë, ndjenjat dhe ndërthurjen e dashurisë dhe besimit të ndarë me të tjerët. Ndaj, edhe pasi të kthehemi në rrugët e zakonshme të jetës tonë, kujtimet e atyre momenteve të pashembullta mbeten të ndriçojnë rrugën tonë, duke na kujtuar për fuqinë e shpirtit, për jetën dhe për dashurinë që ndajmë me njëri-tjetrin dhe me botën që na rrethon.

Shkruan: Bardhec Berisha – Bardhi, Neudorf



(Foto: Avgustin Ramaj)



(Foto: Gjane Simoni)

Të shtunën më 18 maj, në Misionin tonë në Luzern, festuam Ditën e Nënës. Edhe pse ishte ditë pune dhe shumica e grave ishin të zëna me shumë angazhime pune dhe familjare, rreth 150 gra - nëna gjetën kohën dhe mundësinë për të marrë pjesë në këtë festë të përbashkët.

Don Anton Uka, misionari ynë, e hapi programin me fjalët më të bukura dhe të merituar, duke vlerësuar jashtëzakonisht shumë rolin e nënës si në shoqëri dhe në veçanti në familje. Përveç punës dhe detyrës familjare që kryejnë pa u lodhur, Nënata - Gratë tona janë të gatshme të bëjnë gjithçka



(Foto: Don Anton Uka)

për të ndihmuar dhe dhënë kontributin e tyre në Misionin tonë në bashkëpunim me Motrat Bijat e Dashurisë Hyjnore.

Ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit u bënë ndryshime në stafin e Forumit të Grave. Pas një periudhe të gjatë angazhimi dhe përgjegjësie si kryetare e Forumit të Grave, zonja Vjollca Bisaku, u zëvendësua nga zonja Lume Malota. Don Antoni, falënderoi përzemërsisht Vjollcën për detyrën e kryer me përkushtim dhe dashuri të madhe, për kujdesin dhe shembullin e saj të shkëlqyer, si dhe për angazhimin e palodhur në Mision. Ndërsa Lumes, në emër të të gjithave, i është uruar mbarësi dhe bekim në detyrën e re.

Për shkak të nevojës së stafit të Forumit të Grave janë pranuar edhe disa anëtare të reja si pjesë e stafit, të cilat edhe më parë kanë qenë të angazhuara në Mision. Vera Frrokaj, Gita Berisha, Leonia Kabashi, Leonida Komani dhe Merlinda Bisaku janë anëtarët e reja të stafit të cilat i përshëndeti don Antoni duke ju dëshiruar mirëseardhje dhe bashkëpunim të mirë.

Pas hapjes së festës dhe lutjes fillestare, festa vazhdoi me këngë e vallëzim ku falë atmosferës së bukur të ofruar nga këngëtari Astrit Mula dhe stafi i tij, të pranishmet mbetën mjaft të kënaqura.

Përveç muzikës dhe pjesës argëtuese të përgatitur nga Valentina Pernrecaj, kishim edhe ushqime të shijshme të përgatitura nga Shtjefën Spaqi.

Falënderojmë Zotin për të gjitha të mirat që na jep dhe na ofron, dhe në emër të stafit dhe emrit tim personal falënderojmë don Antonin dhe Motrat për bashkëpunimin e mirë dhe dëshirën që të mblihdemi dhe të festojmë së bashku çdo vit.

Shkruan: Vjollca Bisaku, Ballwil



(Foto: Lume Malota)

Çfarë është Nëna?

A dëshiron ta dishë çfarë është nëna?
Askush, askush prej fëmijëve nuk e di.
Një fëmijë lind dhe ... shkon.

Dikush e di, ndoshta, por vonë,
e dinë ata që nuk e kanë më.
Çfarë po mendon ndërsa po m'shikon,
a dëshiron ta dishë çfarë është nëna?

Nëna është si një pemë e madhe
që t'jep të gjitha frytet e saj:
për aq sa ia kërkon
gjithmonë do ta gjejë një fryt për ty.
Ajo të jep frutat, lulët, gjethet,
për ty ajo zhvesh gjithçka,
edhe degët do t'i presë.
Nëna është si një pemë e madhe

Nëna është si një burim.
Sa më shumë që ia merr ujin,
aq më shumë do të gurgullojë.
Në fundin e saj nuk do të shohësh baltë:
gjithmonë i freskët, gjithmonë i ndritshëm,
në hije dhe në diell vetëm rrjedh.

Rrjedh vetëm për të shuar etjen tënde,
qesh kur arrin, dhe qanë kur largohesh.
Nëna është si një krua.

Nëna është si deti.
Nuk ka asnjë thesar që nuk e fsheh në brendësi,
vazhdimisht të përkundë me valën
dhe vjen të të puth.
Plagën e saj më të thellë
nuk mund ta bësh të rrjedh gjak,
menjëherë kthehet në ngjyrën e vet, blu.
Nëna është si deti.

Nëna është ky mister:
Gjithçka kupton, gjithçka fal,
Gjithçka vuan, gjithçka jep,
Ajo nuk e merr asnjë lule për kurorën e saj.
Mund të kalosh pranë saj si një i huaj,
mund ta lëndosh atë në çdo gjë.
Ajo do të të thotë: «Rrugë të mbarë, kalorës i pashëm!»
Nëna është ky mister.

(Nga Fraçesko Pastonki)



(Foto: Kastriot Frrokaj)

Përkushtimi dhe përshpirtëria e popullit tonë ndaj shenjtit të Padovës është e veçantë dhe origjinale si në pak popuj të tjerë në botë, siç dëshmoi edhe festa e këtij viti në Luzern.

Gjatë 13-të të martave, kushtuar Shna Ndout, Mesha e shenjtë ishte e mbushur plot me besimtarë të cilët me lutje dhe përshpirtëri dëshmuan dashurinë për Krishtin dhe shenjtërit e Tij.

Edhe në ditën e Shna Ndout, pavarësisht se ishte një ditë pune me shumë angazhime, besimtarë të shumtë gjetën kohë të vijnë në meshë dhe kështu të kremtojmë së bashku festën e Shenjtit të shumë mrekullive.

Për të gjithë të pranishmit, familjet e Misionit tonë përgatitën një apéro të pasur me ushqime të shijshme dhe kështu, pas meshës, në ambientet e Misionit tonë, festuam së bashku festën e Shna Ndout.

Falënderojmë Forumin e Grave dhe të rinjtë e Ansambllit “Shqiponja” sepse janë gjithmonë të gatshëm të ndihmojnë në festimet tona të përbashkëta.

Shenjtë Shna Ndue, lutu për ne dhe për popullin tonë!

Shkruan: Redaksia



(Foto: Kastriot Frrokaj)



(Foto: Kastriot Frrokaj)



Në ambientet e Misionit tonë në Luzern u zhvilluan takimet për përgatitjen e martesës së të rinjve dhe të rejave që do të kurorëzohen gjatë verës së këtij viti.

Temat e takimeve ishin: Natyra dhe kushtet e martesës së krishterë; Martesa e krishterë si thirrje për shenjtëri dhe kuptimi i ritit dhe simboleve të martesës.

Të rinjtë, përveçse dëgjuan me vëmendje konceptet dhe mësimet e shpjeguara nga Don Antoni, morën pjesë aktive edhe duke sjellë përvojën e tyre personale. Pas takimit të fundit kishim darkën e përbashkët të ofruar nga Kelmend Shtufi, pronar

i restorantit të njohur Kelly's në Emmenbrücke. Në darkë morën pjesë edhe disa anëtarë të korit nga Misioni ynë në Luzern.

Xhekë Avgustini, anëtar korit, dha një dëshmi të bukur për të rinjtë, duke treguar gëzimet dhe vështirësitë e jetës bashkëshortore.

Të shoqëruar me ushqime të mira, batuta, këngë dhe vallëzime, në sfond patëm mundësinë të ndjekim ndeshjen e parë të kampionatit evropian të futbollit.

Shkruan: Redaksia



(Foto: Don Anton Uka)



(Foto: Don Anton Uka)

INTERVISTË ME M. MRIKA SABEDINI

MURGESHË ME SHËRBIM NË MISIONIN KATOLIK SHQIPTAR NË LUZERN



Motër, fillimisht të falënderoj nga zemra për kohën e gjetur, për të realizuar këtë intervistë për revistën tonë «Misioni ynë»!

Faleminderit juve që më dhatë mundësinë të ndaj përvojat dhe mendimet e mia me lexuesit e revistës sonë.

Motër Mrika, mund të na tregosh pak për fëmijërinë tënde?

Fëmijëria ime ishte e mbushur me sfida, veçanërisht pas vdekjes së babait tim. Ishim shumë të vegjël dhe përballja me mungesën e tij ishte vërtetë e vështirë. Megjithatë, mbështetja e Zotit dhe përkushtimi ndaj Tij më kanë ndihmuar për t'i kapërcyer këto vështirësi.

Sa e vështirë ishte jeta pas vdekjes së babait tuaj?

Ishte një kohë shumë e vështirë për ne, sepse ishim të vegjël dhe humbja e babait tonë ishte një tronditje e madhe. Por, me ndihmën e Zotit dhe nënës sime, që na rriti dhe edukoi, ia kemi dalë. Nëna ishte një shtyllë e fortë për ne, një grua e jashtëzakonshme dhe një besimtare e madhe, e cila pasi u martua me babanë kaloi nga feja islame në atë katolike. Kështu ja ka arritur të na rrisë edhe pse me shumë mund e sakrifica, e cila kurrë

nuk është dorëzuar. Por tani Zoti e ka shpërblyer Zoti me fëmijët dhe fëmijët e fëmijëve të cilët kanë shumë kujdes për të. Gjithashtu kemi pasur mbështetjen edhe të komunitetit, kështu që kemi arritur të kapërcejmë këtë përiudhë të vështirë.

Ke qenë në moshë shumë të re kur ke vendosur të bëheshe motër nderi. Cilat ishin motivimet dhe qëllimet tua në atë kohë dhe sa i gjen të përmbushura tani?

Qëllimi im ishte t'i shërbeja Zotit duke ndihmuar të tjerët. Ky qëllim më ka udhëhequr gjatë gjithë jetës sime dhe më ka dhënë forcë për të ecur përpara. Sot shoh se ky përkushtim më ka dhënë shumë kënaqësi dhe qetësi të brendshme.

Na tregoni për formimin tuaj dhe përvojat që keni pasur gjatë rrugëtimit tuaj në jetën e kushtuar.

Jam lindur dhe rritur në qytetin e Ferizajt, në Kosovë. Shkollën fillore e kam përfunduar në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme, për Ekonomi komerciale, e kam filluar në Ferizaj dhe dy vite në Kabash të Vitisë. Për shkak të situatës që ishte në atë kohë, jam transferuar në Binçë, ku ishte kuvendi ynë, që të mos isha vetëm si kandidate. Kam qenë dy herë në Zagreb dhe kam shërbyer si kandidate në Dunav – filiale e famullisë së Stubllës, ku qëndrova me M. Otilia Krämer. Mund të them se motra Otilia ishte një shenjtëreshë e gjallë, e cila punonte dhe u shërbente të varfërve në atë fshat malor të zonës së Karadakut. Ajo ishte shumë e dashur dhe e kujdesshme ndaj të gjithëve pa dallim, ndaj më ndihmoi shumë në forcimin e thirrjes

sime. Ajo periudhë ishte shumë e vështirë në aspektin social e politik, sepse ishte koha kur ne nxënësit shqiptarë helmoheshim nga serbët, dhe të gjithë në shkollë e dinin që unë isha për motër, kjo i shtyu ata të tregonin respekt e nder edhe më të madh, si shokët ashtu edhe shoqet, por edhe profesorët. Pas shkollës së mesme shkova në Shkodër, ku vazhdova studimet për katër vjet në Institutin Kateketik, ndërkohë, privatisht, me profesor, studioja muzikë, të cilën e doja shumë, sepse edhe e konsideroja të nevojshme për animacionin e liturgjisë, që edhe sot më ndihmon shumë në shërbimin tim në Luzern.

Tani që keni festuar 50-vjetorin e lindjes dhe 35 vite kushtim dhe shërbim, cilat kanë qenë sfidat më të mëdha që keni ndeshur dhe si i keni kapërcyer ato?

Normalisht kam pasur disa vështirësi, si domos kur isha ndarë nga familja dhe kisha frikë nëse do ia dilja apo jo. Por falë Zotit, ndihmës së tij dhe Kishës, më kanë mbajtur të fortë dhe të vendosur çdo herë. E festova 50 vjetorin me familjen time në Kosovë dhe me anëtarët e korit të Misionit tonë në Luzern dhe me këtë rast i falënderoj sinqerisht të gjithë për mbështetjen e tyre të vazhdueshme.

A mund të na thoni cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë tuaja si motër që shërbeni në Mision?

Detyrat e mia përfshijnë pjesëmarrjen në organizimin e aktiviteteve të ndryshme dhe përgatitjen e liturgjisë në mënyrë që mesha e shenjtë të kremtohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Kemi grupin e korit në Luzern, Willisau dhe Goldau; grupin e ministrantave në të gjitha kishat ku kremtojmë; një grup të vogël fëmijësh që ndjekin mësimin e fesë; grupin e lexuesve; grupin e Forumit të Grave, kemi gjithashtu një grup të këndshëm të

rinjsh, të cilët merren me vallëzim, por edhe në aktivitete të tjera në Misionit. Ne si motra jemi të përfshirë në të gjitha këto grupe.

Sa të suksesshme jeni në punën me të rinjtë dhe të rejat dhe sa jeni të kënaqura me pjesëmarrjen e tyre në aktivitete dhe meshën e shenjtë?

Siç e theksova, kemi një grup të mirë të rinjsh, të cilët janë shumë të gatshëm të ndihmojnë në aktivitetet e përgjithshme që ne kryejmë gjatë vitit në Misionin tonë, shpresojmë që kjo të bëhet një nxitje edhe për të tjerët, veçanërisht për të ardhur në meshë. Është pak e dhimbshme që të rinjtë neglizhojnë meshën e shenjtë. Megjithatë, suksesin tonë si personel i Misionit të Luzernit ia besojmë dashamirësisë së të tjerëve.

Cili është mesazhi juaj për të gjithë lexuesit e revistës "Misioni ynë"?

Ndihem shumë e lumtur dhe e privilegjuar që pas 22 vitesh shërbim në Zvicër m'u dha mundësia të jap këtë intervistë e cila lidhet kryesisht me jetën time. E imja është më shumë se sa një mesazh, është një ftesë drejtuar të gjithëve, veçanërisht të rinjve, që të mos përtojnë të marrin pjesë në Meshën e Shenjtë dhe në aktivitetet tona të shumta përmes të cilave synojmë bashkimin mes tyre dhe njëkohësisht edukimin njerëzor e shpirtëror të të gjithë atyre që marrin pjesë.

Motër Mrika, faleminderit shumë për kohën tuaj dhe ju uroj shëndet dhe mbarësi.

Faleminderit juve për bashkëpunimin tuaj të çmuar në realizimin e intervistave për revistën tonë.

*Intervistoi: Mirlinda Dushi Berisha,
Langnau b. Reiden*



Edhe pse unë dhe kushëriri im Preni u vonuam 10 minuta, të gjithë shtegtarët ishin duke pritur për tu nisur. Në orën 6 e 10 minuta të mëngjesit u takuam të Verkehrshaus në Luzern më grupin e pelegrinëve që do të shtegtonim deri në Einsiedeln. Rrugëtimi i ynë deri në Einsiedeln ishte i gjatë 34 km. Më orë të tëra udhëtuam këmbë deri atje. Ecnim shtigjeve të cilat ishin enkas për shtegtim, por ndonjë moment duhej të kalonim edhe në trotualet e rrugëve të makinave, por krejt shkurt, sidomos në vendbanime.

Shtegtimi në Einsiedeln është një sfidë shpirtërore dhe kulturore e rëndësishme për shumë njerëz, sidomos për ata që e njohin traditën katolike por edhe për ata që duan ta njohin traditën katolike.

Motra Vidë, motra Mrikë, Vilson Spaqi (që udhëhiqte shtegtimin tonë), si dhe grupi i shtegtarëve ishin bërë gati për këtë rrugëtim. Pas lutjes së zakonshme që e bëmë të gjithë se bashku filluam rrugëtimin tonë për në Einsiedeln. Në gjysmën e rrugëtimit na u bashkua edhe dr. don Anton Uka, misionar ynë në Luzern, i cili kësaj radhe zgjodhi që të bashkohet me ne. Por edhe kjo që ai bënte ishte sfiduese, sepse për të ecur këmbë mbi 15 km nuk është punë e vogël.



(Foto: Mërgim Spaqi)

Gjatë rrugës tonë prej Luzerni deri në Einsiedeln përveç lodhjes fizike, bisedave të përbashkëta dhe kuptimplote, rekreacionit, kishim edhe përjetime të tjera që na shoqëruan gjatë kësaj kohe. Ai ishte një pelegrinazh shpirtëror, me reflektim personal, meditues. Mjedisi natyror përreth me kodrat dhe pyjet e qeta ofronte një atmosferë ideale për shtegtim.

Bazilika në Einsiedeln është një abaci tradicionale benediktine, shtëpia e rreth dyzet murgjve, vendi më i rëndësishëm i pelegrinazhit në Zvicër dhe një vend kulture, edukimi dhe takimesh për më shumë se njëmijë vjet. Bazilika i është kushtuar Zojës së Bekuar, Nënës së Jezu Krishtit (Festa e pajtorit më 15 gusht) dhe Shën Mauritius (dita e festës më 22 shtator). Shumë pelegrinë vijnë këtu për të marrë pjesë në ceremonitë fetare. Shtegtarët kanë mundësinë të marrin pjesë në meshë dhe në shërbime të tjera liturgjike. Këto shërbime shpesh përfshijnë këngë gregoriane dhe janë shumë të bukura dhe mbresëlënëse.

Abacia e Einsiedeln ka një histori të lashtë dhe të pasur që daton nga shekulli i 10-të. Shtegtarët

mund të vizitojnë muzeun e Bazilikës dhe manastirit dhe të mësojnë më shumë për historinë dhe kulturën e vendit. Është e famshme për arkitekturën e saj baroke të mahnitshme dhe për brenësinë e pasur me afreske, skulptura dhe altare të bukura. Bazilika dhe Shenjtërorja e Zojës janë veçanërisht mbresëlënëse.

Ne arritëm diku rreth orës 18.00 në oborrin e Bazilikës, bëmë një foto të përbashkët, pushuam paksa dhe në orën 19.00 kishim meshën e shenjtë të cilën e celebroi dr. Don Anton Uka.

Pas Meshës se shenjtë kishim darkën e përbashkët ku dhe patëm rastin të çlodhemi, të bisedojmë se bashku, por normalisht edhe të ushqehemi sepse pas një shtegtimi kaq të gjatë uria e kishte bërë të veten.

Shtegtimi ynë në Einsiedeln ishte një përvojë e pasur dhe shumëdimensionale që kombinon elementet shpirtërore, natyrore, duke na ofruar një përvojë të plotë dhe mbresëlënëse.

Shkruan: Bardhec Berisha – Bardhi, Neudorf



(Foto: Mërgim Spaqi)



Seminari për ungjillëzim, që u mbajt në Luzern, me datat 21-23 mars 2024, me moton: “Dilni në mbarë botën e predikoni Ungjillin të gjithë njerëzve”, ishte shumë i frytshëm. Jezusi i bashkoi të rinjtë dhe të moshuarit ku pjesëmarrësit e ndjenin praninë e Jezusit në jetën e tyre.

Në kohën e sotme, kur takimet mes njerëzve janë të rralla apo sipërfaqësore për shkak të “mungesës” së kohës së lirë, në këtë përvojë erdhën besimtarë të rajoneve të ndryshme të cilët vendosën të kushtonin fundjavën për tu ripërtërirë shpirtërisht dhe për të takuar Zotin. Kjo është një veçori e seminareve për ungjillëzim ku Shpirti Shenjt bën gjithçka aktuale dhe të re.

Ungjillëzimi nuk është i mundur pa Shpirtin Shenjt, filloi në ditën e Rrëshajëve dhe vazhdon edhe sot. T’i sjellësh njerëzit në përvojë të re do të thotë ti ndihmosh ata, për tu bërë dëshmitarë të vërtetë të takimit me Zotin kurse një ditë edhe ata të dëshmojnë dhe të ungjillëzojnë të tjerët duke filluar vazhdimisht nga vetja.

Së pari fitohet përvoja me Zotin duke dëgjuar zemrën e tij, i cila sjell kthesa të reja. Besimtari papritmas e sheh rëndësinë e Zotit dhe të Kishës, e kupton më lehtë Shkrimin Shenjtë. Zoti i afrohet njeriut si mik, jeton me të dhe është mik me të.

Vetë Jezusi thotë: “Ju jeni miqtë e mi” (Gjn 15, 14). Kështu besimtari ndjehet i lumtur kur lutjet e tija plotësohen. Në këtë mënyrë ai bëhet gjithnjë e më shumë i krishterë i ndërgjegjshëm, më i gëzuar dhe më i dobishëm. Besimi nuk i bëhet më një barrë për të, por një hir gëzimi dhe lumturie.



(Foto: Don Anton Uka)



(Foto: Avgustin Ramaj)

Pse feja është barrë dhe dhimbje për disa? Vetëm sepse ata nuk kanë një përvojë të vërtetë besimi dhe të takimit me Zotin. Njerëz të tillë ende nuk e kanë takuar Zotin e gjallë i cili ndërron gjithçka në jetën e tyre.

E tërë kjo bëhet përmes Seminareve për Ungjillëzim ku udhëheqësi duhet të jetë një hap para të tjerëve në përvojën e takimit me Zotin, por i barabartë me të tjerët. Shpirti Shenjt sjell butësinë, harmoninë, dashurinë në jetën e njeriut, në familje dhe në Kishë. Përvoja e besimit është një përvojë e thellë shpirtërore, në të cilën njeriu hapet në atë mënyrë që drita e Zotit të hyjë në të dhe njeriu të ndjejë siguri dhe liri për tu rritur në dashuri.

Të pajtohesh me të vërtetën e Jezusit, ta pranosh atë për drejtues të jetës e bën njeriun të lirë. Sepse e Vërteta nuk është vetëm në nivelin e arsyes, por e mbulon të gjithë qenien njerëzore.

Të jesh pjesëmarrës në një Seminar për Ungjillëzim do të thotë fillimisht të zbulosh se takimi më i rëndësishëm është ai me vetveten. Por për atë qenien e vërtetë, origjinale në projekt që është thirrur të njohë dëshirat më të thella në vetvete dhe të lejojë që Zoti i pranishëm të rivendosë dinjitetin e tij të humbur prej kohësh.

Meqenëse unë isha disa ditë në Zvicër para seminarit që pritej të mbahej, isha i ftuar për vizitë në shumë familje. Dhe, këtu filloi "Mini Seminari" - ripërtëritja shpirtërore nëpër familje që për mua ishte e pa planifikuar por e këndshme. Ajo që ndodhi në ato familje ishte padyshim një ringjallje shpirtërore që i lidhi shumë bashkëshortë dhe anëtarë të familjes mes tyre.

Dua të veçoj një takim me dy të rinj të lodhur e të mërzitur nga aventurat e argëtiveve dhe dëfrimeve. Ata me thirrën në banesën e tyre për një bisedë se si mund të kapërcejnë krizën në të cilën kishin rënë. Pasi treguan krizat dhe pakënaqësitë e tyre nëpër rrugët e gabuar, unë fillova t'ju flas për Jezusin dhe t'ju dëshmoj se si unë e kam takuar Jezusin e ngjallur dhe si jam kthyer bga Ai kur isha në moshën e tyre. Dëshmia ime i preki shumë, aq shumë sa që njeri prej tyre filloi të qajë me zë të lartë derisa sa unë flisja. U preken shpjet dhe shumë nga prania e Zotit. Pastaj e pyeta atë që qante: Pse po qan? U përgjigj: Po shoh se kam gabuar rrugën, jam duke jetuar pa Zotin. Pastaj duke i mbajtur për dore fillova të lutem duke ju drejtuar Jezusit që prek me hirin e tij. Vaji i tyre u shtua edhe më shumë. Në fund i udhëzoja që sa më parë të shkojnë në rrëfim të meshtari për tu penduar dhe për tu liruar. Tani jam në kontakt të përhershëm për ti përkrahur në jetën e re në të cilën, janë shumë të lumtur për kthimin fillestar nga Zoti.

Porosia ime

Bota nuk mund të bëhet më e mirë nëse Kisha nuk ripërtërihet në vazhdimësi. Nuk ka ungjillëzim të frytshëm pa dorëzimin e përditshëm të vetes në jetën e Zotit sipas parimit: plotësisht i yti, o Zot (Totus Tuus ego sum Domine). Kjo është çështje e rëndësishme e kohës sonë. Nëse fjalët tona nuk përputhen me Ungjillin, njerëzit nuk na besojnë! Sepse, feja përcillet me jetë e jo me anë të teorisë pa u vërtetuar edhe në praktikë me jetë dhe dashuri. Për këtë shenjtërit ishin ungjillëzuesit më të mirë që i njeht Kisha dhe bota.

Kur mungon kthimi nga Zoti është punë e kotë të doktrinohet (të japësh njohuri) njeriu në fe e mos ta sjellim deri të përvoja e fesë. Sepse vetëm "njeriu e kthyer nga Zoti" mund ta mësojmë për të vërtetat e fesë. Në realitet ai pastaj vetë e kërkon edukimin e fesë, kërkon që ta thellojë fenë e vet nga të gjitha anët në përputhje me të Vërtetën e zbuluar. Atij pastaj praktika e fesë i paraqitet si nevojë e shpirtit kur nuk është më "konsumues i shërbimeve fetare", por është zbatues i asaj që bart në vete.

Kisha bën thirrje të vazhdueshme për ungjillëzim të ri. Hapi i parë që duhet bërë është ky: "Fol, o Zot, shërbëtori yt dëgjon".

Shkruan: Dedë Palokaj, arkeolog – Prishtinë



FESTA E KORPIT DHE GJAKUT TË KRISHTIT

(Foto: Nue Tuqi)

Në datën 30 maj, si çdo vit, në kishën famullitare të Willisaut, ku çdo muaj kremtohet Mesha e shenjtë në gjuhën shqipe, së bashku me besimtarët zviceranë kremtuam Meshën e shenjtë. Pas Meshës së shenjtë, procesioni u zhvillua nëpër qytetin e Willisaut, me një organizim shumë të bukur dhe madhështor. Procesioni u shoqërua nga banda muzikore e qytetit, grupe të ndryshme me kostume kombëtare, fëmijë të Kungimit të parë dhe besimtarë të shumtë, përfshirë

edhe besimtarët shqiptarët. Pas Meshës së shenjtë u ofrua një aperitiv nga famullia e Willisaut për të gjithë të pranishmit. Kështu së bashku vazhduam të bisedonim me njëri-tjetrin nën tingujt e muzikës klasike.

Në mbrëmje në kishën e famullisë së Shën Mihillit në Luzern, misionari Don Anton Uka kremtoi meshën e shenjtë në gjuhën shqipe, në të cilën morën pjesë një numër i mirë besimtarësh tanë.

Me kremtimin e Korpit dhe Gjakut të Krishtit kremtojmë misterin e Eukaristisë së Shenjtë, domethënë Trupin dhe Gjakun e Krishtit. Ky mister bëhet i pranishëm në çdo Meshë të shenjtë kur, pasi prifti shqipton fjalët e shenjtërit (shugurimit), buka dhe vera bëhen Trupi dhe Gjakun e vërtetë të Krishtit. Kjo ndodh në një mënyrë të mrekullueshme, ku të dyja substancat, si buka pa maja dhe vera natyrale, e pastër, ruajnë cilësitë e tyre të jashtme, por thelbi i tyre ndryshon. Me këtë festë dëshirojmë të ripërtërijmë besimin tonë në Jezu Krishtin, Birin e Hyjit, i cili në një moment të caktuar u bë njeri dhe nëpërmjet Trupit dhe Gjakut të tij qëndron gjithmonë me ne, bashkohet me ne dhe na jepet si ushqim shpirtëror.



(Foto: Nue Tuqi)

Shkruan: m. Vida Ademi



MBYLLJA E MUAJIT MAJ

(Foto: Nue Tuqi)

Më 31 maj në shenjtëroren e vogël të Luthern Bad, me lutjen e Rruzares, litanitë e Zojës dhe kremtimin e Meshës së shenjtë, përmbyllëm muajin maj, i cili është një muaj kushtuar në veçanti Zojës së Bekuar. Falënderuam kështu Zotin dhe kërkuam ndërmjetësimin e virgjërës Mari për paqen në botë dhe në familjet tona.

Edhe pse koha ishte jo e mirë, me shi dhe kohë mjaft e ftohtë, besimtarët tanë nuk u dorëzuan por morën pjesë një numër i konsiderueshëm në lutje dhe në Meshën shenje që është kremtuar në oborrin e shenjtërores. Nderim ndaj Marisë, Nënës së Hyjit nga ana e besimtarëve tanë tregon se ajo e meriton dhe si besimtarët e përjetojnë si Nënë të veten dhe shembullin më të lartë të besimit. Vetëm ajo prej gjithë njerëzve ishte e zgjedhur të ketë nderin të bëhet Nëna e Shpëtimtarit dhe ajo misionin e vet në më-

nyrë të plotë e ka plotësuar, dhe me dëgjesën e vet ka kontribuar për shëlbimin tonë. Për këtë me gëzim mbështetemi në ndërmjetësimin e saj, duke kërkuar që të ndërmjetësojë për ne te Biri i saj dhe Biri i Zotit.

Shkruan: m. Vida Ademi

Takimi i delegatëve

Më 21 maj 2024, në Emmen u zhvillua mbledhja e delegatëve të Kujdesit Baritor të Migrantëve në Luzern.

Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues nga Misioni ynë, Llesh Duhanaj nga Këshilli Administrativ, dhe delegatët Flora Rosaj dhe Leonard Demaj. Kurse motër Vida Ademi dhe Gjane Simoni u bashkuan në pjesën informative.

Kryetari i Këshillit Administrativ, Dr. Cornelio F. Zraggen, informoi për aktivitetet në vazhdim dhe bëri një pasqyrë të aktiviteteve të ardhshme. Ndërsa, Vikari ipeshkvor Hanspeter Wasmer, raportoi për aktivitetet e Komisionit Baritor. Në mënyrë të veçantë u theksua “Nata e gjatë e Kisha-ve” e cila do të zhvillohet më 23 maj 2025.

Pas takimit kishim darkën e përbashkët dhe një mbrëmje të këndshme, e cila u organizua nga misioni portugez.

Shkruan: Gjane Simoni, Luzern



(Foto: Nue Tuqi)



KISHA KATOLIKE KREMTON ZEMRËN E KRISHTIT

(Foto: R.V.)

Kisha katolike romake kremton festën e Zembrës së Krishtit, simbol real, që na do gjithmonë e na fal. Zemra e Krishtit nuk është simbol i trilluar, dashuria e Jezusit është jetë, që të ngjall nga të vdekurit. Solemniteti i Zembrës së Krishtit na pohon se ‘Dashuria është më e fort se vdekja’. Jo vetëm, libri i Biblës, Kënga e Këngëve pohon (8,6) se “dashuria është e fortë si vdekja”, por kjo festë e Zembrës së Krishtit deklaron më shumë, se “dashuria është më e fort se vdekja”. Kjo është forca e dashurisë shpëtimprurëse (shelbuese) e Krishtit, që me sakrificën e vet e ka fituar, madje mposhtur vdekjen e ka sjellë fitoren e ringjalljes. Kjo fitore nxirret në pah nga kulti kushtuar Zembrës së Shenjtë të Jezu Krishtit.

Muajin qershor Kisha ia kushton Zembrës së Krishtit

Sikur muajin maj që Kisha ia kushtoi Zojës së Bekuar, kështu muajin qershor, Kisha ia kushton Zembrës së Jezu Krishtit. Kjo traditë buron nga

përshpirtëria popullore, lex orandi e Papa Leoni XIII me Enciklikën ‘Annum sacrum’ ‘Viti Shenjt’ të 25 majit 1899 ia ka kushtuar mbarë njerëzimin Zembrës së Krishtit. Që nga kjo kohë e deri më sot, vijon kjo traditë e bukur të cilën populli i krishterë e ka kaq përzemër.

Zemra e Shenjtnueshme e Jezu Krishtit është shprehja më e lartë njerëzore e dashurisë hyjnore, duke kujtuar se festa e Zembrës së Krishtit i jep tonin të gjitha ditëve të muajit qershor. Përshpirtëria popullore, i vlerëson shumë simbolet, e Zemra e Jezu Krishtit simbolizon vetë mëshirën e Hyjit. Por nuk është ndonjë simbol i trilluar, është i vërtetë, përfaqëson qendrën, burimin prej nga gurrton shëlbimi për mbarë njerëzimin.

Nga Zemra e Jezusit buron falja dhe jeta

Fragmente të ndryshme ungjillore nënvizojnë se nga Zemra e Jezusit buron falja e jeta, për të gjithë njerëzit. Por mëshira e Jezusit nuk është ve-

tëm ndjenjë; është edhe forcë; forcë, që jep jetë, që e ringjall njeriun. E dokumenton këtë Shën Luka Ungjilltar, në episodën e vejushës së Nain, fshat i Galileesë, ku Jezusi me dishepujt e tij arrin pikërisht në çastin kur kremtohet një funeral. Ka vdekur biri i vetëm i një vejushe. Nëna e përcjell në varr shpre-sëhumbur, e mbytur në lot. E pikërisht mbi sytë e saj të përplotur ngulën sytë e Zotit. Duke e parë, Krishti ka mëshirë për të.

Kjo mëshirë është dashuria e Zotit për njeriun, është sjellja e Zotit, në takim me mjerimin njerëzor, me skamin tonë, vuajtjen tonë, ankthin e zemrës sonë. Vetë termi biblik 'mëshirë', të kujton dashurinë e thellë amtare, dashuri e pashoqe, që vetëm zemra e nënës e ndjen për krijesat e mishit e të gjakut të vet. Kështu na do Zoti, thotë Shkrimi Shenjt.

Po cili është fryti i kësaj dashurie? Është jeta! Mëshira e Zotit i jep njeriut jetë. Zoti na shikon gjithnjë me mëshirë, na pret me mëshirë. Nuk duhet të kemi frikë t'i afrohem Atij! Ka një zemër plot me mëshirë. Nëse ia zbulojmë plagët e shpirtit tonë, mëkatet tona, Ai na fal, gjithnjë. Është mëshirë e pastër.

Të jesh i devotshëm i Zemrës së Krishtit

Do të thotë ta adhurosh Zemrën e Krishtit si seli të dashurisë së Zotit e të mëshirës së tij të pambaruar. Jezu Krishti e bëri të dukshme dashurinë e Atit përmes Zemrës së Tij njerëzore, të ndjeshme, plot me dashuri e mëshirë. Kulti publik liturgjik i Zemrës së Krishtit bazohet mbi zbulimet që vetë Zemra e Krishtit i bëri motrës së shenjtë, Margerita Marisë e, para saj, edhe mistikëve të tjerë.

Jezusi iu duk nën formën e një dielli të shkëlqyer e i tha këto fjalë: 'Kjo zemër e shporuar mbi Kryq nga dashuria, në vend që të gjejë ndër njerëz dashuri e mirënjohje, gjen përbuzje, fyerje e deri blasfemi'. E Jezusi i tha rishtas: 'E shpëtova botën me Kryqin e mundimeve të mia. E tani dua ta shpëtoj përsëri, duke i treguar Zemrën time, oqeani i mëshirës sime të pambaruar'.

E më pas Krishti kërkoi kultin, jo vetëm individual, por edhe publik e shoqëror, kultin liturgjik, me themelimin e festës së Zemrës së tij të Shuguruar ditën e parë pas tetëditshes të Solemnitetit të Korpit të Krishtit. Jezusi ka thënë: mësoni nga unë që jam zemërbutë e i përvujtë. Dhe jeta jonë ka lindur e duhet të përtërihet nga Zemra e shporuar e Jezu Krishtit.

Lajmëtari i Zemrës së Jezu Krishtit në Shqipëri

Revista e parë fetare në Shqipëri, "Elçija e Zëmërs së Jezu Krishtit", që duke filluar nga viti 1914 do të titullohej "Lajmëtari i Zëmërs së Jezu Krishtit", u bë edhe lajmëtare e parë e Zemrës Hyjnore ndër shqiptarë. Nisi të botohej që më 1891 nga etërit jezuitë. Kjo revistë fetare kulturore u shkrua në dialektin gegë me alfabetin e shkrimtarëve të vjetër të Shqipërisë veriore dhe atë italian deri më 1909, pastaj vazhdoi me alfabetin e Manastirit.

Pati edhe një Shtojcë kulturore që vijoi të botohej nga viti 1909 deri më 1913. Më 1914-1916 shtojca u botua më vete me titull "Përparimi" - titull ky që shpreh simbolikisht qëllimin themelor të veprimtarisë së Kishës Katolike në Shqipëri. Drejtori i parë i revistës ka qenë At Jak Jungu (1891-1896). Penat më të forta të "Lajmëtarit" kanë qenë: Imzot Lazër Mjeda, Imzot Luigj Bumçi, Dom Ndue Bytyqi, Filip Shiroka, Dom Pashk Babi dhe pothuajse të gjithë etërit jezuitë, ndër të cilët shquhet pena e themeluesit të shkollës letrare jezuite, At Anton Xanonit.

Në një libër të vjetër uratësh në shqip gjetëm këtë fjalë, që në këtë festë, e përherë, Jezusi na thotë: "M'a çil zërmën o njeri: Dishroj me ndejë me ty!" Jezu Krisht, zemërbutë dhe i përvujtë. Bëj që zemra ime t'i përngjajë Zemrës sate.

(Marrë nga Radio Vatikani)



(Fozo: R.V.)



(Foto: Catholic News Agency)

KARLO AKUTIS I SHENJTË

Papa Françesku ka njohur mrekullinë që i atribuohet ndërmjetësimit të të Lumit Karlo Akutis, duke i hapur rrugën e shenjtërimit të tij si shenjt i parë i shekullit 21.

Adoleshenti italian i programimit kompjuterik, i cili vdiq nga kanceri në vitin 2006, njihet për përkushtimin e tij të madh ndaj pranisë së vërtetë të Jezusit në Eukaristi.

Njohja e mrekullisë së dytë që i atribuohet ndërmjetësimit të Akutis bën të mundur që Akutis të mund të shenjtërohet gjatë Vitit Jubilar 2025 në Kishën Katolike.

Në një dekret të 23 majit, Papa Françesku miratoi shërimin e mrekullueshëm të një vajze 21-vjeçare nga Kosta Rika të quajtur Valeria Valverde, e cila ishte afër vdekjes pasi u plagos rëndë në kokë gjatë një aksidenti me biçikletë ndërsa studionte në Firence në vitin 2022.

Pasi vajza iu nënshtrua një kraniotomie urgjente për të ulur presionin intrakranial, familjes iu tha se situata e saj ishte shumë kritike dhe se ajo mund të vdiste në çdo moment, sipas Dikasterit të Vatikanit për Çështjen e shenjtërve.

Gjashtë ditë pas aksidentit, nëna e Valerias shkoi në një shtegtim në Asizi për t'u lutur për shërimin e vajzës së saj në varrin e të Lumit Karlo Akutis, duke lënë një shënim të shkruar.

Në të njëjtën ditë, Valeria filloi të merrte frymë vetë dhe të nesërmen ajo rifitoi përdorimin e gjymtyrëve të sipërme dhe pjesërisht e rifitoi edhe të folurim.

Valeria doli nga reparti e kujdesit intensiv 10 ditë pas shtegtimit të nënës së saj dhe iu nënshtrua testeve të mëtejshme që treguan se kontuzionet hemorragjike kortikale të përkohshme në të djathtën e trurit të saj ishin zhdukur plotësisht.

Ndryshe nga parashikimet mjekësore, Valeria kaloi vetëm një javë në terapi fizike dhe më 2 shtator 2022, dy muaj pas aksidentit të saj, ajo shkoi në një shtegtim në varrin e Karlo Akutis në Asizi me nënën e saj për të falënderuar për shërimin e saj të plotë.

Shenjt i parë në shekullin 21

I lindur në vitin 1991, Karlo Akutis është i Lumturi i parë i këtij mijëvjeçari që e lumturoi Kisha Katolike.

Menjëherë pas Kungimit të tij të parë në moshën 7-vjeçare, Karlo i tha nënës së tij: “Të jem gjithmonë i bashkuar me Jezusin: Ky është plani im i jetës”. Për ta arritur këtë, Karlo u përpoq të ndiqte meshën e përditshme sa më shpesh të ishte e mundur në kishën e famullisë përballë shkollës së tij fillore në Milano.

Karlo e quajti Eukaristinë “autostrada ime për në Parajsë” dhe bëri gjithçka që ishte në fuqinë e tij për ta bërë të njohur këtë prani. Dëshmia e tij i frymëzoi prindërit e tij që të ktheheshin në praktikimin e besimit katolik, si dhe shoqen e tij që i përkiste besimit hindu, të kthehej dhe të pagëzohej.

Karlo ishte një fëmijë i aftë për teknologjinë, i donte kompjuterat, kafshët dhe videoljërë. Udhëhësi i tij shpirtëror tha se Karlo ishte i bindur se dëshmitë e mrekullive eukaristike mund të ishin bindëse për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë se Jezusi është i pranishëm në çdo Meshë.

Gjatë dy viteve e gjysmë, Karlo punoi me familjen e tij për të krijuar një ekspozitë mbi mrekullitë eukaristike që u shfaq premierë në vitin 2005 gjatë Vitit të Eukaristisë, të cilin e shpalli Papa Gjoni Pali II dhe që atëherë ka vazhduar të paraqitet në mijëra famulli në pesë kontinentet.

Shumë nga shokët e klasës, miqtë dhe anëtarët e familjes së Karlos kanë dëshmuar se si ai i afroi ata me Hyjin. Karlo ishte një person shumë i hapur dhe nuk kishte turp të fliste me shokët e tij të klasës dhe këdo që takonte për gjërat që donte: Meshën, praninë e Jezusit në Eukaristi dhe Parrizin.

Mbahet mend se ka thënë: “Njerëzit që rrinë para diellit nxihen; njerëzit që rrinë përpara Eukaristisë bëhen të shenjtë”.

(Burimi i tekstit: Catholic News Agency)



(Foto: R.V.)



(Foto: R.V.)



(Foto: Anonim)

BILDUNGSREISE IN DEN KOSOVO

Vom 27. April bis 3. Mai 2024, habe ich zusammen mit meiner Frau Trudi an der von fabia Luzern organisierten Bildungsreise in den Kosovo teilgenommen. Es war die dritte und letzte Reise, die fabia Luzern in den Kosovo organisiert hat. Insgesamt waren wir fünf Teilnehmer.

In Pristina angekommen, sah ich in der Mutter Theresa-Kathedrale Don Agim Qerkini wieder. Am Abend konnte ich einer Priesterweihe beiwohnen. Die Priesterweihe war sehr eindrücklich und dauerte über zwei Stunden. Es waren über 60 Priester anwesend. Bischoff Dode hat die Priesterweihe vorgenommen. Im Anschluss fand im Pfarrsaal unter der Kirche ein grosser Apéro statt und ich konnte Bischoff Dode zur gelungenen Priesterweihe gratulieren. Don Agim hat mir auch die Bibliothek gezeigt und mich informiert, dass er ein Buch über den heiligen Johannes (in albanischer Sprache) geschrieben hat.

Die Mutter Theresa-Kathedrale hat mir sehr gut gefallen. Aktuell ist der Rohbau des zweiten Turmes erstellt. Es wird noch eine Weile dauern, bis der Turm und auch die Umgebung fertiggestellt sein werden.

In Prizren habe ich Schwester Anna getroffen, welche uns die alte Kirche, die Kathedrale unserer lieben Frau, gezeigt hat.

Das Ziel der Bildungsreise stand unter dem Motto: «Erleben Sie Kultur, Gesellschaft und Politik eines jungen Staates». Unser lokaler Reiseführer, Xhevdet Kallaba, hat es verstanden, innerhalb der kurzen Zeit uns den Kosovo zu zeigen.



(Foto: Hans-Peter Bucher)

Viel Zeit hat er aufgewendet, uns die Geschichte, vor allem in der Zeit rund um die Staatsgründung zu erklären. Wir haben u. a. das Amselfeld, die Gedenkstätte «Memorial Adem Jashari in Prekaz besucht und die Brücke in Mitrovica überquert. Man spürte förmlich das mulmige Gefühl. Auf der einen Seite Kosovo-Flaggen, dazwischen KAFOR-Truppen und auf der anderen Seite die Flaggen Serbiens. Serbien und andere Länder haben bekanntlich den Staat Kosovo bisher noch nicht anerkannt. Man hat den Eindruck, dass der Kosovo durch diese Situation in seiner Entwicklung blockiert ist.

Am Morgen wurden wir jeweils um 05.15 Uhr vom Muezzin geweckt. Dies verdeutlicht klar, dass im Kosovo über 93 Prozent Muslime wohnen. Ich war überrascht, dass der Anteil der Katholiken nur zwei bis drei Prozent beträgt. Die Minarette und mit ihnen der türkische Einfluss war klar zu spüren.

Landschaftlich hat der Kosovo sehr viel zu bieten. Das Klima ist mild und in der Ferne ragen Schneeberge, welche das Land abgrenzen. Überrascht war ich von den unzähligen unvollendeten Häuser, die überall stehen. Es scheint keine Bauvorschriften zu geben. Nachdenklich haben mich auch die vielen Schuttablagerungen an den Strassenrändern und der überall herumliegende Abfall gestimmt.

Positiv überrascht war ich von den vielen jungen Leuten, welche in diesem Land ihr Bestes geben und trotz der schwierigen wirtschaftlichen Lage sich für ihr Land einsetzen. Auch das Essen, das für uns Schweizer fast nichts gekostet hat, hat sehr gemundet.

Ein Besuch beim kosovarischen Fernsehen und beim neuen Botschafter der Schweiz in Pristina, Jürg Sprecher, haben die Bildungsreise abgerundet.

Shkruan: Hans-Peter Bucher, Luzern



(Foto: Hans-Peter Bucher)



Don Anton Uka, misionar i Misionit Katolik Shqiptar në Luzern, u zgjodh nga dioqeza e Bazelit për të qenë pjesë e Komisionit Dioqezan për Çështjet Ndërkulturore.

Komisioni përbëhet nga 12 persona, njohës dhe specialistë të sektorit, të cilët do të përpiqen t'u përgjigjen sfidave të kohës përmes punës, diskutimit dhe reflektimit për çështjet aktuale fetare dhe ndërkulturore.

Qëllimi i këtij Komisioni Baritor është shkëmbimi i njohurive dhe përvojave ndërkulturore si një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin e komuniteteve të krishtera, dhe jo vetëm, në këtë drejtim.

Ne e urojmë Don Antonin për këtë detyrë të re, duke i uruar bekime dhe suksese në punën e tij.

Shkruan: Redaksia



BABAI DHE FUNKSIONI I TIJ

Nëse funksioni i nënës është ti zhvillojë fëmijës dëshirën për jetën, funksioni i babait është ti zhvillojë fëmijë “dëshirën për ligj”. Është e vërtetë që ky funksion nuk është aspak i lehtë, se vetë babai nuk e di. Ky konstatim nuk është për të fyer figurën e babait por për të kuptuar e pranuar vështirësitë që baballarët hasin në veten e tyre dhe për pasojë në raport me fëmijët e tyre.

Në traditën tonë, babai qëndron larg fëmijëve sepse sjell vetëm të mira materiale dhe me fëmijët merret vetëm nëna. Edhe pse figura e nënës është shumë e rëndësishme, me dëshirën për jetën, me sigurinë nuk është e mjaftueshme. Na gënjen mendja se një nënë mund të bëhet edhe baba.

Figura e babait ashtu si figura e nënës janë të pazëvendësueshme për fëmijën. Çdo njeri në këtë botë vjen nëpërmjet dy njerëzve dhe i duhen të dy derisa ai të bëhet vetë i rritur. Tradita jonë çalon shumë në këtë drejtim duke e lenë babanë jashtë rritjes së fëmijës dhe për pasojë nuk ndërtohet

marrëdhënia baba – fëmijë. Do thoni se shpesh ndodh që nëna luan rolin e babait dhe babai rolin e nënës! Po, por janë të dy bashkë. Pra dyshja funksionon. Ndërsa kur babai nuk përfshihet në edukimin e fëmijës prishet ekuilibri i dyshes e cila e krijon jetën.

Nëna është e vërtetë që ofron dashurinë e saj pa kushte që duket si formë ideale, por të gjithë kemi nevojë për disa kufinj që të përftojmë sigurinë. Dhe pikërisht këta kufinj që të ndihmojnë të njohësh veten dhe ta shijosh atë ti ndërton dhe mëson babai. Nga kohë shumë të vjetra vjen një thënie e madhe: Të shkruarit e ligjit jo në gur po në “mish të zembrës” ose thënë ndryshe dëshira për ligj dhe ky është funksioni i babait. Pra babai të mëson që gjerat nuk bëhen nga inati apo se humbasim kontrollin por pikërisht se kemi mësuar të dëshirojmë ligjin pra ti zgjedhim veprim që do të bëjmë.

Shkruan: Lira Gjika, Tiranë



PËRZEMËRSIA DHE HUMORI

(Foto: Don Anton Uka)

Përzemërsia dhe humori, janë nga ndihmësit kryesorë të një edukatori apo mësuesi, për përçueshmërinë dhe drejtimin e nxënësve drejt rrugës së vetes dhe jetës.

Mësues, përpuniquni të jini të përzemërt me nxënësit tuaj. Tregojini gjërat, që kanë mësuar dhe

bërë mirë. Mos u lodhni duke gjetur gabimet e tyre. Nxitini ti gjejnë vetë. Nëse vërtet doni ti ndihmoni nxënësit tregojuni arritjet dhe jo të metat apo mosarritjet. Tregojini se edhe ju nuk keni lindur të ditur apo mësues, por jeni përpjekur si ata, nxënësit tuaj dhe keni mësuar fort dhe nuk jeni mërzitur e tërhequr, kur nuk i bënit mirë detyrat apo nuk arrinit rezultatet, që dëshironi.

Me këmbëngulje dhe duke dëgjuar këshillat dhe sugjerimet e të rriturve, prindër e mësues, sot jeni përpara nxënësve tuaj, si mësues dhe së bashku të bëni më të mirën. Shkolla është vendi dhe institucioni, që zhvillon mendjen e fëmijëve duke u mësuar njerëzoren. Mësuesit janë pjesa e gjallë e institucionit shkollë. Përpuniquni mësues, dhe bëjini “ndihmësit dhe mjetet” tuaja, përzemërsinë dhe humorin. Është vërtetuar edhe shkencërisht që janë “ndihmësit dhe mjetet” më të mira, për të bërë një fëmijë, një njeri të zotin, vetja dhe qytetar të mirë.



(Foto: Don Anton Uka)

Shkruan: Lira Gjika, Tiranë



(Foto: Pixabay)

Jedes Jahr, wenn der Sommer in der Schweiz Einzug hält, beginnt für viele von uns eine besondere Zeit: Die Heimreise in den geliebten Kosovo. Die Vorfreude auf die Reise in die Heimat, in den Kosovo, erfüllt uns mit Freude und Stolz. Diese Reise ist nicht nur eine Flucht aus dem Alltag, sondern auch eine Rückkehr zu unseren Wurzeln, zu unserer Familie und zu den Freunden, die uns in der Ferne fehlen und um die Schönheit unseres kostbaren Landes zu geniessen.

Die Bedeutung der Heimat

Der Kosovo ist nicht nur unser Geburtsort, sondern eine Perle, die uns allen am Herzen liegt. Wenn wir in unser Heimatland zurückkehren, bringen wir nicht nur unser Gepäck mit, sondern auch die Verantwortung, dieses wunderschöne Land mit Respekt und Würde zu behandeln. Es ist wichtig, dass wir uns daran erinnern, wie kostbar unser Land ist und dass unser Verhalten einen grossen Einfluss auf die Wahrnehmung und den Zustand unseres Heimatlandes hat.

Bescheidenheit und Respekt

Es ist verständlich, dass wir stolz auf das sind, was wir im Ausland erreicht haben. Doch wir sollten darauf achten, unsere materiellen Güter nicht zur Schau zu stellen. Anstatt mit teuren Autos, Kleidung oder elektronischen Geräten zu prahlen, sollten wir Bescheidenheit und unsere Werte zeigen. Unser Ziel sollte es sein, als Vorbilder zu agieren, die den Einheimischen Respekt entgegenbringen und ihnen auf Augenhöhe begegnen. Immerhin sind das unsere Brüder und Schwestern, welche, während unserer Abwesenheit unser geliebtes Heimatland schützen, pflegen und hegen.

Umweltschutz: Unser Land wie unseren eigenen Garten behandeln

Unsere Verantwortung erstreckt sich auch auf die Umwelt und die Tiere. Der Kosovo ist unsere Heimat, unsere «Nana jon», die wir über alles lieben. Es ist unsere Pflicht, das Land sauber und unberührt zu halten. Keinen Müll auf den Boden zu werfen, die Natur zu respektieren und nachhaltig zu handeln.

Das sind einfache, aber effektive Wege, um unsere Wertschätzung gegenüber unserem Heimatland zu zeigen. Indem wir das Land wie unseren eigenen Garten behandeln, sichern wir seine Schönheit und Reinheit für zukünftige Generationen.

Ein Vorbild sein

Wenn wir in den Kosovo reisen, haben wir die Gelegenheit, ein positives Beispiel zu setzen. Dies kann durch kleine, aber bedeutsame Taten geschehen: Freundlichkeit gegenüber unseren Mitmenschen, Hilfsbereitschaft und das Engagement für Gemeinschaftsprojekte. Indem wir diese Werte vorleben, und wir den Einheimischen, Freundlichkeit, Hilfsbereitschaft und ein offenes Ohr für ihre Anliegen schenken, dies sollte selbstverständlich sein. Wenn wir diesen Respekt zeigen, setzen wir ein Beispiel für den Umgang miteinander und fördern ein harmonisches Miteinander.

Ein Vorbild für zukünftige Generationen

Während wir uns als Vorbilder verhalten, tragen wir dazu bei, das Bild unseres Landes positiv zu prägen. Dies bedeutet, Verantwortung zu übernehmen, Respekt zu zeigen und in allem, was wir tun, die höchsten moralischen Standards zu wahren. Unsere Handlungen können einen bleibenden

Eindruck hinterlassen und die Werte unserer Kultur lebendig halten.

Stolz auf unser Erbe: Die Illyrischen Wurzeln

Als Nachfahren der Illyrer haben wir eine reiche Geschichte und Kultur, auf die wir stolz sein können. Unsere Vorfahren haben uns Werte wie Ehre, Mut und Gemeinschaftssinn hinterlassen. Diese alten Werte der Ur-Albaner und -Albanerinnen sind tief in uns verwurzelt und sollten in unserem Verhalten widerspiegelt werden. Wenn wir diese Werte leben und teilen, können wir einen positiven Unterschied in der Welt machen.

Die Sommerzeit im Kosovo ist eine wunderbare Gelegenheit, unsere Wurzeln zu pflegen und die Verbindung zu unserem Heimatland zu stärken. Es liegt an uns, diese Zeit mit Respekt, Würde und Bescheidenheit zu nutzen. Indem wir unsere Heimat wie einen wertvollen Schatz behandeln, nicht mit unseren materiellen Gütern prahlen und die Einheimischen respektieren, können wir dazu beitragen, das Bild unseres Landes positiv zu beeinflussen. Lasst uns Kosovo mit Liebe und Sorgfalt behandeln, damit es weiterhin als die Perle erstrahlt, die es für uns alle ist.

Shkruan: Bergita Krasniqi, Luzern



(Foto: Pixabay)

**AZB 6005 Luzern
Post CH AG**
Erscheint 4 x jährlich

Redaktionsschluss:
Nr. 3/2024
15. September 2024

Erscheint im
September 2024

Impressum

Misioni Katolik Shqiptar në Luzern
Katholische Albanische Mission in Luzern

Verlag und Redaktion

Dr. Don Anton Uka, Përgjegjës
Rodteggstrasse 6
CH-6005 Luzern
Tel: +41 41 250 52 60
Cel: +41 79 371 68 91
E-Mail: ukas_cr@hotmail.com
anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch

Mitteilungsblatt für die Mitglieder des Vereins
der Katholischen Albanischen Mission in Luzern.

In memoriam: AT ANTONIO BELUSHIT **(1934–2024)**

Zoti thirri pranë vetes Papas Antonio Bellusci-n (Zotin Ndon). Figura unike e priftit të Epar-kisë së Lungros (Ungra në arbërisht), studiues i traditës, përhapës i gjuhës dhe i kulturës arbë-reshe e mbi të gjitha mik i të gjithë atyre, që pa-tën fatin ta njohin. Veprimtaria e tij në Eparki u karakterizua nga përkushtimi i thellë dhe puna baritore në të gjitha bashkësitë ku shërbeu.

Tipari kryesor i apostullimit të tij ishte afër-sia e madhe me njerëzit, problemet e të cilëve i kuptonte, sepse ai vetë vinte nga një familje e përvuajtur, por me frikën e Tënzot. Për këto ar-sye, është vlerësuar gjithmonë nga ipeshkvijtë dhe nga meshtarët e dioqezave të tjera.

Krahas angazhimit baritor, Zoti Ndon i ka kushtuar gjithë kohën e vet mbrojtjes, promo-vimit dhe vlerësimit të trashëgimisë arbëreshe. Duket se dëshira e tij më e madhe ishte të rilidhte arbëreshët e shpërndarë nëpër botë, prandaj, u bë udhëtar i palodhur, që nga viti 1965 deri më 1990 kreu misione të ndryshme në Greqi, në vendet arbërore (kështu i quan ai në punën e tij kërkimore «studime ndër arbëro-

rët e Helladës), si edhe në vitin 1987, gjatë një vizite organizuar nga Bureau pour les langues moins repandues të Komisionit Evropian.

U miqësua me arbëreshët e Gjermanisë, të SHBA-ve dhe të Zvicrës, të cilët e donin fort. Këto udhëtime, këto kërkime, që përfshijnë reg-jistrime këngësh dhe vjershash, si edhe burime origjinale, dokumentohen në vepra dhe tekste të rëndësishme për antropologët dhe etnolo-gët. Qëllimi ishte të gjallëroheshin e të bëhes-hin të dukshme dëshmitë gjuhësore e kulturore të arbëreshëve të shpërndarë nëpër botë.

Puna e tij u kurorëzua në bibliotekën "A. Bel-lusci" të Frascineto-s (Frasnita), të cilën e the-meloi vetë. Krahas mijëra vëllimeve me tema albanologjike dhe shpirtërore greko-bizantine, aty gjenden të gjitha botimet e tij, dokumentet e punës kërkimore dhe një arkiv i rëndësishëm personal.

I përjetshëm është kujtimi yt, vëlla i dashur.

(Prof. Domenico Morelli – Shkëputur nga R.V.)

Të ndihmojmë Misionin tonë!

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3

Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 | 6005 Luzern